





# EKONOMIA DHE BUXHETI

## 2014



# Raporti Mujor

Korrik 2014

Kontakt:

e-mail: [marsed.harizi@financa.gov.al](mailto:marsed.harizi@financa.gov.al)

e-mail: [ernil.sabaj@financa.gov.al](mailto:ernil.sabaj@financa.gov.al)

(website - [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al))

## PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR.....	13


## VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin korrik 2014 arriti në 115.86 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin korrik ishte 1.8 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin korrik 2014 ishte 103.26 lekë për dollarë dhe 139.91 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit korrik shënuan kuotat 1.90 për ato 12-mujore, 1.36 për 6-mujoret , 1.06 për qind për depozitat 3-mujore dhe 2.03 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.39 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.31 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,159,8 miliardë lekë në muajin korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 2.1 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për periudhën T2 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 67.5 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar- korrik 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 29.9 miliardë lekë, ose 50.9 për qind më pak e planit për këtë muaj (e cila ishte 60.9 miliardë).
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - korrik 2014, arritën në rreth 206.2 miliardë lekë, ose 102 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 236 miliardë lekë, ose 89.7 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

## ZHVILLIMET EKONOMIKE

### 1.Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin korrik 2014 shënoi një rënie prej -0.6 për qind krahasuar me muajin qershor '14, kur ky indeks shënonte një rënie prej -0.7 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit maj '14, ky indeks ishte -1.1 për qind më i ulët se në muajin prill'14. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti



**Ndryshimet mujore të IÇK-së**

Burimi: INSTAT

dhe shërbime të ndryshme” me 8.47 për qind (duke kontribuar me 0.4 pikë përqindje në normën e inflacionit).

Norma vjetore e inflacionit në muajin korrik arriti në 1.8 për qind, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.


**Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2013</b>	2.7	2.5	2.4	2.3	2.1	2.3
<b>2014</b>	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2013</b>	1.6	1.2	1.7	1.7	1.0	1.9
<b>2014</b>	<b>1.8</b>					

Burimi: INSTAT

## 2.Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin korrik2014, arriti në 139.91 lekë/euro, duke shënuar një rënie me 0.2 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit korrik, një euro u këmbye me 139.02 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin korrik 2014, arriti në 103.26 lekë/dollarë duke



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit korr'14**


Burimi: Banka e Shqipërisë

shënuar një rritje prej 0.2 për qind kundrejt muajit qershor '14. Në fund të muajit korrik, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 103.81 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin korrik të vitit të kaluar,rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 3.7 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është mbiçmuar me 0.3 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.738 euro/dollarë.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrja nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit korrik 2014, normat e interesit të depozitave 12 mujore në lekë arritën kuotën e 1.90 për qind, duke shënuar një rritje me 0.14 pikë përqindje krahasuar me muajin



qershor 2014. Rritje për këtë muaj ka patur edhe në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 3 dhe 6-mujore respektivisht me 0.09 dhe 0.03 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 1.06 dhe 1.36 për qind. Rënie për këtë muaj ka patur në normën e interesit të depozitave me afat të maturimit 1-mujor me 0.03 pikë përqindje, duke shënuar 2.03 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.



e interesit të huave me afate maturimi 6 dhe 12-mujore.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit korrikp ësoi një rritje me 0.19 pikë përqindje, duke arritur në 8.39 për qind nga 8.20 për qind që ishte në muajin qershor 2014. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore shënoi një rënieme 1.09 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin korrik arriti në 8.31për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit korrik 2014, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.23, 3.16dhe 2.95 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në yield-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit 12-mujore, 6-mujore dhe ato 3-mujore, me respektivisht 0.03, 0.02 dhe 0.07 pikë përqindje.

## 4.Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën janar–qershor 2014 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 67.5 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5.

Kontributin më të madh në të e jep zëri i “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -617.9 milionë euro, duke u rritur në vlerë absolute me 16.7% krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2013. “Llogaria kapitale dhe financiare” për 6-mujorin e parë vitit 2014 rezultoi të jetë me një deficit prej 345.41 milionë euro, ose gati 166% më e ulët se në 6-mujorin e parë të vitit 2013.


Fig-5



**Bilanci i Pagesave T2 2014**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-6



**Llogaria Korrente T2 2014**

Burimi: Banka e Shqipërisë


Kompozicioni i llogarisë korrente prej 617.9 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar – qershor '14: (i) bilanci tregtar - 932.5 mln euro, (ii) shërbime neto 34.0 mln euro, (iii) të ardhura neto -35.2mln euro, (iv) transferta neto 315.9 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.



## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit korrik 2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 28,015.1 milionë lekë krahasuar me korrikunë vitit 2013. Kjo rritje ka ardhur si

Fig-7




pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në bankat e nivelit të dytë me rreth 33,969.2 milionë lekë .Në zvogëlimin e këtij efekti rritës ndikoi nga ana tjetër dhe rënia e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 5,954.1 milionë lekë.

**Ecuria e M.V.N. të sistemit në korr'13 - korr'14**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-8



**Agregati M3 korr'13 - korr'14**

Burimi: Banka e Shqipërisë


mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

Në muajin korrik'14 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 61.9 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin qershor '14, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 5,219.2 milionë lekë. Në zvogëlimin e këtij efekti rritës ndikoi nga ana tjetër rënia e nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 5,157.3 milionë lekë duke e ndihmuar edhe më tepër rritjen e

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin korrik 2014 arriti në 550.6 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi gjatë muajit korrik një rritje me vlerë 2.7 miliardë lekë, pra një rritje prej rreth 0.5 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas

Fig-9




**Rritja e stokut total të kredisë**

Burimi: Banka e Shqipërisë

monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.0 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 325.1 miliardë lekë. Gjatë muajit korrik 2014, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredisë, me rreth 66.6 për qind ose 366.5 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.3 për qind ose 150.4 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.5 dhe 1.6 për qind apo 24.6 dhe 8.6 miliardë lekë.

Fig-10



**Përberja e kredisë korr '14**

Burimi: Banka e Shqipërisë


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin korrik '14, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredisë në lekë, me rreth 55.9 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.4 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 8.8 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredisë në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.0 për qind dhe rreth 23.1 për qind.

## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin korrik ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës qeshor 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1,159.8 miliardë lekë në fund të muajit

korrik'14 duke shënuar një rritje prej 7.2 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin qeshor '14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 2.1 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës qeshor'14, oferta e parasë pësoi një rritje të lehtë prej 0.6 për qind.


Fig-11



Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3


Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 2.0 miliardë lekë në krahasim me muajin korrik 2013. Depozitat në valutë gjatë muajit qeshor'14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 88.0 për qind të tyre.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit korrik2014, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 88.0 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.1 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.8 për qind.

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

“Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.8 për qind dhe rreth 11.7 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi totalë me rreth 87 për qind e totalit (në lekë).

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 832.8 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 957.8 miliardë lekë në muajin korrik 2014.

Fig-14



**Përberja e depozitave korr '14**

Burimi: Banka e Shqipërisë

1.22 miliardë lekë.

Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (99.4 miliardë), “Korporata jofinanciare publike” (15.8 miliardë) dhe “korporata të tjera financiare” (8.2 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.4 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit korrik 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rritje prej 2.65 miliardë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 1.43 miliardë lekë si dhe e rritjes së depozitave në lekë me rreth

## SEKTORI FISKAL

### 1.Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - korrik 2014 janë mbledhur rreth 206.2 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 236 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 186.4 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 23.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 37.1% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 102% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 89.7% të këtij plani. Shpenzimet korrente

janë rreth 94.9% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 73.6% të tij.


Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 141.3 miliardë lekë (ose rreth 98.9% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 7.6 miliardë lekë (ose rreth 132.1% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore 37.1 miliardë lekë (ose rreth 99.7% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 13.9 miliardë lekë (ose rreth 122.1% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 186.4 miliardë lekë, 40.9 miliardë lekë (22% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 23.4 miliardë lekë (12.6%) për interesat, 14.6 miliardë lekë (7.8%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 700 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 77.9 miliardë lekë (41.8%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 14.8 miliardë lekë (8%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 14 miliardë lekë (7.5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 55.3% (shpenzime personeli), 50.4% (shpenzime për interesat), 41.3% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 43.8% (subvencione), 57.2% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 44.8% dhe 61.1% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 31%, ndërsa financimi i huaj është 39% e planifikimit të tyre vjetor.

Fig - 15



Treguesit Fiskal, janar - korrik 2014

Burimi: Ministria e Financave

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - korrik 2014 ishin rreth 206.2miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 185.9 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 13.9 miliardë lekë.

**Tab - 2** Të ardhurat gjatë janar - korrik 2014 (në mld Lekë)

Burimi	kor '14	kor'13	Ndryshimi në (%)
TVSH	70.7	60.7	16.5
Tatimi mbi fitimin	12.6	9.4	34
Taksa doganore	3.3	3.1	6.5
Taksat nacionale	18.6	15.6	19.2
Akcizat	19.9	19.6	1.5
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	16.2	17.1	-5.3

Burimi: Ministria e Financave: Statistika Fiskale Mujore: janar -korrik 2014.

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 29.9 miliardë lekë, për periudhën janar - korrik 2014, u mbështet në vlerën 23.3 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 6.6miliardë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 88.9% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afat-gjata (rreth 33.4% të totalit të deficit).

Për muajin korrik 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 30.977 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 38.638 miliardë lekë,

Në realizimin e të ardhurave për muajin korrik 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 28.4 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.1 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
Janar	0.4	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	0.40	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	2.1	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	January
Shkurt	0.7	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	0.55	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	February
Mars	0.6	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.57	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	1.6	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	March
Prill	-0.1	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	0.40	0.42	0.60	0.58	0.55	0.53	1.9	3.7	4.1	1.6	2.3	1.7	April
Maj	-0.8	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	0.16	0.10	0.26	0.32	0.24	0.20	2.1	3.3	4.2	1.9	2.1	1.6	May
Qershor	-0.6	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	0.03	-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05	2.3	3.2	3.9	2.2	2.3	1.5	June
<b>Korrik</b>	-0.7	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	<b>-0.6</b>	-0.07	-0.10	-0.07	0.08	-0.03	<b>-0.04</b>	2.2	3.4	3.6	2.7	1.6	<b>1.8</b>	<b>July</b>
Gusht	0.7	0.8	0.3	0.4	-0.1		0.03	0.01	-0.02	0.12	-0.04		2.2	3.5	3.1	2.8	1.2		August
Shtator	0.8	0.7	0.4	0.2	0.8		0.11	0.09	0.02	0.13	0.06		2.0	3.4	2.8	2.6	1.7		September
Tetor	0.4	0.2	0.4	0.2	0.1		0.14	0.10	0.06	0.14	0.04		2.3	3.0	3.0	2.4	1.7		October
Nëntor	0.4	0.2	0.1	0.2	-0.5		0.16	0.11	0.06	0.14	0.01		2.8	2.8	2.9	2.5	1.0		November
Dhjetor	1.6	2.2	1.0	0.9	1.7		0.28	0.28	0.14	0.20	0.15		3.7	3.4	1.7	2.4	1.9		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania



**Tab - 2** Kursi i këmbimit  
Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj (*Lek per unit of foreign currency*)

Monedha	2009	2010	2011	2012	2013	2014							Currency
						Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	
<i>Mesatarja e periudhës</i>													<i>Average of period</i>
USD	94.98	103.94	100.90	108.18	105.67	103.24	102.75	101.55	101.35	101.89	103.09	103.26	USD
EURO	132.06	137.79	140.33	139.04	140.27	140.54	140.32	140.29	140.01	139.99	140.13	139.91	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>													<i>In the end of period</i>
USD	95.81	104.00	107.54	105.85	101.86	103.66	101.58	101.89	101.36	102.72	102.78	103.81	USD
EURO	137.96	138.77	138.93	139.59	140.20	140.44	140.14	140.27	140.08	139.86	140.26	139.02	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014							
Në përqindje						Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	In percent
<b>Norma e depozitave</b>													<b>Deposits rates</b>
12-M	6.78	6.07	5.87	5.38	4.17	2.39	2.46	2.16	2.21	1.94	1.76	1.90	12-M
6-M	5.74	5.16	4.87	4.50	3.40	1.87	1.87	1.66	1.80	1.62	1.33	1.36	6-M
3-M	5.05	4.42	4.22	3.83	2.72	1.31	1.53	1.12	1.22	1.07	0.97	1.06	3-M
1-M	4.56	4.70	4.39	3.62	2.79	2.43	2.51	2.25	2.21	2.12	2.06	2.03	1-M
<b>Norma e huasë</b>													<b>Lending rates</b>
12-M	12.46	11.52	11.17	10.28	9.52	8.67	8.49	6.47	8.60	9.50	8.20	8.39	12-M
6-M	12.54	11.69	12.28	10.61	9.59	9.36	8.77	9.34	8.00	8.61	9.40	8.31	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>													<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/													Treasury bills 1/
3-M	6.30	5.29	5.31	5.03	3.40	3.36	3.24	3.14	-	3.05	3.02	2.95	3-M
6-M	7.52	6.41	6.23	5.65	3.54	3.71	3.52	3.40	3.32	3.27	3.14	3.16	6-M
12-M	9.14	7.09	6.95	6.37	3.66	3.82	3.79	3.66	3.56	3.40	3.26	3.23	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4

## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

Nr.	E M È R T I M I							ITEMS
	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	
	<b>27,774</b>	<b>53,273</b>	<b>82,107</b>	<b>116,161</b>	<b>144,587</b>	<b>175,206</b>	<b>206,183</b>	TOTAL REVENUE
<b>I.</b>	<b>624</b>	<b>1,658</b>	<b>2,991</b>	<b>3,507</b>	<b>4,053</b>	<b>5,345</b>	<b>6,369</b>	Grands
<b>II.</b>	<b>24,326</b>	<b>47,226</b>	<b>73,627</b>	<b>103,682</b>	<b>129,906</b>	<b>157,502</b>	<b>185,910</b>	Tax Revenue
<b>II.1</b>	<b>17,534</b>	<b>35,349</b>	<b>56,298</b>	<b>77,924</b>	<b>98,335</b>	<b>120,335</b>	<b>141,282</b>	From tax offices and customs
1	9,472	19,155	28,677	40,626	50,331	61,177	70,693	V.A. T
2	1,007	2,363	6,332	7,950	9,477	11,167	12,587	Profit Tax
3	1,616	3,660	6,110	9,083	12,500	16,274	19,923	Excise Tax
4	2,569	4,576	6,444	8,716	10,903	13,160	16,242	Personal Income Tax
5	2,482	4,806	7,494	9,842	12,869	15,802	18,582	National Taxes and others
6	388	789	1,241	1,707	2,255	2,755	3,255	Customs Duties
<b>II.2</b>	<b>796</b>	<b>1,340</b>	<b>2,162</b>	<b>4,462</b>	<b>5,448</b>	<b>6,235</b>	<b>7,571</b>	Revenues from Local Gov.
1	154	340	663	1,691	1,931	2,211	2,412	Property Tax
2	304	329	350	379	612	685	1,318	Small Business Tax
3	338	671	1,149	2,392	2,905	3,339	3,841	Local Taxes
<b>II.3</b>	<b>5,996</b>	<b>10,537</b>	<b>15,167</b>	<b>21,296</b>	<b>26,123</b>	<b>30,932</b>	<b>37,057</b>	Social ins. contributions
1	5,257	9,209	12,860	18,429	22,562	26,776	32,160	Social Insurance
2	735	1,319	2,283	2,831	3,522	4,105	4,841	Health insurance
3	4	9	24	36	39	51	56	Revenues for property compensation
<b>III.</b>	<b>2,824</b>	<b>4,389</b>	<b>5,489</b>	<b>8,972</b>	<b>10,628</b>	<b>12,359</b>	<b>13,904</b>	Nontax Revenue
1	165	320	430	1,871	1,951	1,951	1,951	Profit transfer from BOA
2	1,810	2,630	3,254	4,818	5,654	6,575	7,116	Income of budgetary institutions
3	498	498	498	498	504	765	1,362	Divident
4	139	404	612	842	1,363	1,602	1,805	Tariffs on services
5	212	537	695	943	1,156	1,466	1,670	Other/not allocated
	<b>24,963</b>	<b>54,269</b>	<b>88,415</b>	<b>122,526</b>	<b>156,331</b>	<b>197,401</b>	<b>236,039</b>	TOTAL EXPENDITURE
<b>I.</b>	<b>24,285</b>	<b>51,451</b>	<b>77,884</b>	<b>103,308</b>	<b>131,222</b>	<b>158,492</b>	<b>186,355</b>	Current Expenditures
<b>I.1</b>	<b>5,645</b>	<b>11,394</b>	<b>17,268</b>	<b>23,174</b>	<b>29,083</b>	<b>34,938</b>	<b>40,905</b>	Personnel expenditures
1	4,856	9,811	14,864	19,954	25,031	30,068	35,215	Wages
2	789	1,583	2,404	3,220	4,052	4,870	5,690	Social insurance contributions
<b>I.2</b>	<b>3,819</b>	<b>7,843</b>	<b>10,675</b>	<b>13,039</b>	<b>17,255</b>	<b>20,627</b>	<b>23,399</b>	Interest
1	3,476	7,058	9,502	11,290	15,144	18,075	20,521	Domestic
2	343	785	1,173	1,749	2,111	2,552	2,878	Foreign
<b>I.3</b>	<b>1,275</b>	<b>3,225</b>	<b>6,425</b>	<b>8,256</b>	<b>9,670</b>	<b>11,418</b>	<b>14,588</b>	Operational & Maintenance
<b>I.4</b>	<b>58</b>	<b>112</b>	<b>265</b>	<b>310</b>	<b>422</b>	<b>579</b>	<b>700</b>	Subsidies
<b>I.6</b>	<b>9,440</b>	<b>20,875</b>	<b>31,372</b>	<b>42,422</b>	<b>54,379</b>	<b>66,726</b>	<b>77,929</b>	Social insurance outlays
1	7,432	15,127	23,165	31,405	39,633	48,179	56,742	Social insurance
2	2,008	4,754	7,213	10,023	13,752	17,253	19,893	Health insurance
3			994	994	994	1,294	1,294	Expenditures for Owners Compensation
<b>I.7</b>	<b>1,214</b>	<b>3,120</b>	<b>5,041</b>	<b>7,535</b>	<b>9,927</b>	<b>12,121</b>	<b>14,837</b>	Local budget expenditure
<b>I.8</b>	<b>2,834</b>	<b>4,882</b>	<b>6,838</b>	<b>8,572</b>	<b>10,486</b>	<b>12,083</b>	<b>13,997</b>	Other expenditures
1	112	198	294	387	454	522	591	Unemployment insurance benefits
2	2,721	4,684	6,544	8,170	9,970	11,427	13,167	Social assistance
5				15	62	134	239	Compensation for ex-political prisoners
<b>III</b>	<b>678</b>	<b>2,818</b>	<b>10,531</b>	<b>11,466</b>	<b>13,734</b>	<b>19,817</b>	<b>23,935</b>	Capital expenditures
1		641	1,309	4,025	4,615	7,109	8,893	Domestically financing
2	678	2,177	9,222	7,441	9,119	12,708	15,042	Foreign financed
	<b>2,811</b>	<b>-996</b>	<b>-6,308</b>	<b>-6,365</b>	<b>-11,744</b>	<b>-22,195</b>	<b>-29,856</b>	CASH BALANCE
	<b>-2,811</b>	<b>996</b>	<b>6,308</b>	<b>6,365</b>	<b>11,744</b>	<b>22,195</b>	<b>29,856</b>	CASH BALANCE FINANCING
<b>Brendshëm</b>	<b>-2,179</b>	<b>1,745</b>	<b>1,959</b>	<b>5,673</b>	<b>10,493</b>	<b>16,474</b>	<b>23,306</b>	Domestic
Të ardhura nga privatizimi			1	2	4	10	11	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	3,473	4,696	8,647	11,026	15,576	21,436	26,539	Domestic new borrowing (net)
Nacionale	3,482	4,707	8,660	11,048	15,600	21,419	26,336	Other
Lokale	-9	-11	-13	-22	-24	17	203	Foreign
Të tjera	-5,652	-2,952	-8,208	-4,474	-5,818	-4,972	-3,244	Other
Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	1,838	4,269	771	2,125	3,815	3,145	2,435	Government deposits into the Central Bank
Të tjera	-7,489	-7,219	-8,978	-6,598	-9,631	-8,116	-5,680	Other
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-3,545	-3,102	-3,585	-3,093	-4,137	-4,309	-4,426	Deposits of Social and Health insurance
Mjete në ruajtje	6	57	23	120	124	318	524	Preservation stock
Nënhua	314	369	552	916	1,029	1,049	1,105	On-Loan Principal
Detyrim ndaj ISSH	-220	-99	-303	712	78	5	70	Liabilities to SSI
Të tjera (detyrime të përkohshme)	-4,044	-4,444	-6,689	-450	242	110	3,087	Other-Float
<b>I huaj</b>	<b>-632</b>	<b>-749</b>	<b>1,366</b>	<b>817</b>	<b>1,304</b>	<b>5,721</b>	<b>6,550</b>	Foreign
Hua afatgjatë (e marrë)	198	534	3,153	3,996	9,562	8,390	9,986	Long-term foreign borrowing (gross)
Nga e cila nënhua			1,665	1,642	1,670	2,109	2,145	
Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-142	-44	51	185	240	-808	-747	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-688	-1,385	-1,984	-7,399	-8,498	-10,125	-10,953	Repayments
Mbështetje Buxhetore	0	146	146	3835	4526	8264	8264	Budgetary Support

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2014

Table of investments 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>0</b>	<b>641</b>	<b>1,309</b>	<b>4,025</b>	<b>4,615</b>	<b>7,109</b>	<b>8,893</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	0.00	22.75	12.43	35.10	33.60	35.87	37.15	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>678</b>	<b>2,177</b>	<b>9,222</b>	<b>7,441</b>	<b>9,119</b>	<b>12,708</b>	<b>15,042</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	100.00	77.25	87.57	64.90	66.40	64.13	62.85	In %
<b>Totali</b>	<b>678</b>	<b>2,818</b>	<b>10,531</b>	<b>11,466</b>	<b>13,734</b>	<b>19,817</b>	<b>23,935</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2014 (CUSTOMS REVENUES 2014)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	
Taksë doganore	388	789	1,241	1,707	2,255	2,755	3,255	Customs Duties
TVSH	6,594	13,683	20,478	29,944	37,927	46,543	54,528	V.A.T
Akcizë	1,616	3,660	6,109	9,083	12,499	16,273	19,922	Excises
Të tjera	612	1,153	1,765	2,582	3,192	4,041	4,473	Others
<b>TOTALI</b>	<b>9,210</b>	<b>19,285</b>	<b>29,593</b>	<b>43,316</b>	<b>55,873</b>	<b>69,612</b>	<b>82,178</b>	<b>Total</b>

## TË ARDHURAT TATIMORE 2013 (TAX REVENUE )

TVSH	2,879	5,472	8,199	10,650	12,236	14,634	16,166	V.A.T
Akciza	0	0	0	1	1	1	1	Excises
Tatim mbi fitimin	1,007	2,363	6,332	7,950	9,477	11,167	12,587	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	2,568	4,575	6,444	8,716	10,902	13,160	16,242	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,870	3,653	5,729	7,260	9,677	11,761	14,109	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>8,324</b>	<b>16,063</b>	<b>26,704</b>	<b>34,577</b>	<b>42,293</b>	<b>50,723</b>	<b>59,105</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>17,534</b>	<b>35,348</b>	<b>56,297</b>	<b>77,893</b>	<b>98,166</b>	<b>120,335</b>	<b>141,283</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2014

The Deficit and Its Financing for 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qersh June	Korrik July	
